VENDIM
Nr. 372, datë 3.5.2013

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR FINANCIMIN E SHPENZIMEVE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MË 23 QERSHOR 2013

(Ndryshuar me VKM nr. 637, datë 31.7.2013)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 "Për buxhetin e vitit 2013", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të vitit 2013, t'i shtohet një fond prej 521 000 000 (pesëqind e njëzet e një milionë) lekësh, nga i cili 45 000 000 (dyzet e pesë milionë) lekë, për shpenzime personeli, për kryerjen e pagesave për komisionerët e KZAZ-ve, qendrave të votimit dhe grupeve të numërimit; 436 000 000 (katërqind e tridhjetë e gjashtë milionë) lekë, për shpenzime operative, për projektet SEN dhe SEV, dhe 40 000 000 (dyzet milionë) lekë për shpenzime për investime.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit për vitin 2013.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha